USAID
NGA POPULLI AMERIKAN

MINISTRIA E SHËNDETËSISË
SPITALI UNIVERSITAR
OBSTETRIK – GJINEKOLOGJIK
MBRETERESHA GERALDINE

MANAXHIMI I BURIMEVE NJEREZORE

RREGULLORE E BRENDSHME

Korrik 2013

Ky publikim u mundësua nga Agjensia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar. U pregatit nga SUOGJ Mbreteresha Geraldinë nëpërmjet Projektit "Mbështetje Reformës në Shëndetësi".

Citim i rekomanduar: SUOGJ Mbreteresha Geraldine nëpërmjet Projektit "Mbështetje Reformës në Shëndetësi" Korrik 2013. Manaxhimi i Burimeve Njerëzore – Rregullore e brendshme e spitalit.

Projekti i USAID "Mbështetje Reformës në Shëndetësi" menaxhohet nga Abt Associates nën kontratën 182-C-00-10-00104-00

REFUZIM
Pikëpamjet e autorit të shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar ose të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara

PERMBAJTJA E RREGULLORES

PERMBAJTJA E RREGULLORES 3

1. PJESA E PARE - PROGRAM ORIENTIMI PËR PUNONJËSIN E RI 4

1.1 QELLIMI 5
1.2 MIRSEARDHJE 5
1.3 MISIONI 5
1.4 PREZANTIMI ME SEKTORINE E BURIMEVE NJEREZORE 5
1.5 DOSJA PERSONALE 5
1.6 NJOHJA ME PËRSHKRIMIN/DHE PREZANTIMIN E VËNDIT TË PUNËS 6
1.7 KONTRATA ME SPITALIN 6
1.8 PREZANTIMI ME PROGRAMIN E KONTROLLIT TË INFEKSIONEVE 6
1.9 PREZANTIMI ME PROGRAMIN E RAPORTIMIT TË INCIDENTEVE 6
1.10 PREZANTIMI ME PROGRAMIN E VIZITORËVE NË SPITAL 6
1.11 RREGULLAT E SJELLJES 6
1.12 NJOHJA ME MASAT DISIPLINORE 7
1.13 ZHVILLIMI I BURIMEVE NJERZORE: KËRKESA PËR TRAJNIM DHE EDUKIM NË VAZHDIM 7
1.14 POLITIKA E MBROJTJES, KONFIDENCIALITETIT DHE INTEGRITETIT TË INFORMACIONIT. 7
1.15 DISA RREGULLA TË THJESHTA 8
1.16 POLITIKA KUNDËR DUHANIT 8
1.17 UNIFORMA VESHJA NË SPITAL 8
1.18 KODI I VESHJES NË SPITAL 8
1.19 PROGRAMI PËR TË DREJTAT E PERSONELIT 9
1.20 VLERËSIMI I PERFOMANCËS 9
1.21 PJESËMARRJA NË ZHVILLIMIN PROFESIONAL TË VAZHDUESHËM 9
1.22 MUNGESAT NË PUNË DHE PUSHIMI VJETOR 10

2. PJESA E DYTE: PERSHKRIMET E PUNES 12

3. PJESA E TRETE – VLERESIMI I PERFORMANCES... 119

4. PJESA E KATERT – POLITIKA E IDENTIFIKIMIT TE PERSONELIT 122

4.1 QËLLIMI 123
4.2 SYNIMI 123
4.3 PROCEDURA 123

1. PJESA E PARE - PROGRAM ORIENTIMI PËR PUNONJËSIN E RI

Punoi:

- Mirlinda Krasniqi — Shefe e Burimeve Njerëzore
- Adriana Kopani — Specialiste e Burimeve Njerëzore
- Anxhela Palla — Juriste
- Maksim Gjoni — N/D për Akreditimin
- Alba Prifti — N/Drejtoreshë Ekonomike
- Aurora Bajraktari — K/Mami Shërbimi
- Megi Dumi — Ekonomiste

1.1 QELLIMI

Qëllimi i programit të orientimit eshte nje menyre prezantimi per punonjesit e rinj me vendin e tyre te punes si dhe me mundesite dhe pergjegjesite ne pune.

1.2 MIRSEARDHJE

Mirë se vini në Spitalin Universitar Obstetrik- Gjinekologjik "Mbretëresha Geraldinë"!

Ky është fillimi i një udhëtimi në rrugën e karrierës tuaj.

Në këtë program orientimi ka shumë detaje të përfshira në fillimin e një pozicioni të ri si: plotësimin e dokumentacionit të duhur, njohja me politikat dhe proçedurat e Spitalit, etj.

Ky program orientimi synon përmirësimin e efikasitetit të shërbimit, lehtësimin e punës së personelit dhe rritjen e kënaqësisë në punë duke rritur vlerën e shërbimeve të ofruara.

Përqasja juaj me spitalin është në vazhdimësi.

1.3 MISIONI

T'i shërbejmë, diagnostikojmë dhe trajtojmë gruan gjatë gjithë jetës së saj dhe ta edukojmë atë për një jetë të gjatë e të shëndetshme.

Qëllimi ynë final është që të arrijmë rezultatet më të mira për të gjithë pacientët që përfitojnë nga shërbimet tona, duke u shndërruar në të njëjtën kohë dhe në qëndër trajnimi model për sistemin tonë shëndetsor.

- Integriteti - Ne gjithmonë veprojmë me profesionalizëm dhe ndershmëri të plotë dhe presim të njëjtën gjë prej atyre që do të punojnë me ne.
- Përgjegjësia – Ne mbajmë veten përgjegjës për komunitetin dhe njëri-tjetrin në kryerjen e detyrave tona dhe të punojmë si një ekip.
- Diversiteti – Ne njohim dhe pranojmë diversitetin individual, respektojmë e mbështesim në mënyrë aktive ndryshimet në mendim, përmes fjalëve dhe veprimeve tona.
- Shërbimet – Ne angazhohemi për të siguruar shërbime gjithnjë e më të mira, në mënyrë që të përmbushim standardet e akreditimit. Të gjithë punonjësit e rinj duhet të jenë të njohur me informacionin themelor për sigurinë, pajtueshmërinë, konfidencialitetin, kontrollin e infeksioneve dhe politikat e burimeve njerëzore.

1.4 PREZANTIMI ME SEKTORINE E BURIMEVE NJEREZORE

Burimeve Njerëzore njohin punonjësit e rinj me kulturën e punës në spital, mjedisin dhe vlerat e spitalit me qëllim që të ofrohet kujdes shëndetësor sa më i mirë. Spitali i prezanton punonjësit e rinj me mundësitë për rritje dhe aftësim profesional që i ofrohet çdo punonjësi.

1.5 DOSJA PERSONALE

Sektori i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore është sektori përgjegjës për mirëmbajtjen e dosjeve të personelit.

Çdo dosje personeli duhet të përmbajë informacionin që vijon:

- Një kopje të kontratës individuale të punësimit
- Diploma përkatëse (e noterizuar)
- Kopje te kualifikimeve pas universitare (po te kete)
- Titull Akademik (e noterizuar)
- Libreza e punësimit (origjinale)
- Libreza shëndetësore

- Curriculum Vitae
- Raport aftësimi mjeko-ligjor.
- Çdo dokument tjetër që ka lidhje me marrëdhëniet e punës që kërkohet nga punëdhënësi.

1.6 NJOHJA ME PËRSHKRIMIN/DHE PREZANTIMIN E VËNDIT TË PUNËS

Çdo punonjës do të njihet me Përshkrimin e Punës që do të bëjë (detyrat dhe pergjegjesitë e pozicionit), si dhe do të prezantohet me personelin/vëndin e punës ku do të punojë.

1.7 KONTRATA ME SPITALIN

Çdo punonjës i spitalit do të ketë një kontratë individuale të punësimit, sipas rregullave të Kodit të Punës.

Kontrata individuale e punës përmban, elementët që vijojnë:

- Objekti i kontratës
- Periudha e vlefshmërisë, pavarësisht nga kohëzgjatja e kontratës
- Koha e provës, ku kërkohet:
  - Orari i punës
  - Përshkrimi i punës dhe detyrat specifike
  - Detyrimet e punonjësit
  - Detyrimet e punëdhënësit
  - Pagesa dhe shpërblimet
  - Proçedurat e zgjidhjes së konflikteve

1.8 PREZANTIMI ME PROGRAMIN E KONTROLLIT TË INFEKSIONEVE

Qëllimi i këtij programi është identifikimi i praktikave të shëndosha të kontrollimit të infeksioneve që zbatohen dhe ndiqen në spital. Per referncë jepet kopje e politikës së kontrollit të infeksioneve.

1.9 PREZANTIMI ME PROGRAMIN E RAPORTIMIT TË INCIDENTEVE

Punonjesi i ri do të njihet me udhëzimet për raportimin e incidenteve në spital dhe proçedurat mbështetëse që do të promovojnë raportimin e të gjitha kategorive të incidenteve dhe gabimeve duke përfshirë edhe Incidentet Serioze. Punonjësi njihet me qasjen që ndjek spitali ndaj këtij programi, duke mbeshtetur në çdo rast personelin dhe duke mbajtur një qëndrim pozitiv dhe jo-ndëshkues.

1.10 PREZANTIMI ME PROGRAMIN E VIZITORËVE NË SPITAL

Punonjësi i ri do të njihet me programin e Vizitorëve në spital i cili ka për qëllim të krijojë një ambient të sigurt, të parrezikshëm dhe të organizuar për personelin, pacientet dhe vizitorët. Programi i Vizitorëve i njeh me të drejtat e pacientëve për të pritur vizita pasi kjo praktikë përmirëson cilësinë e shërbimit, forcon integritetin e familjes dhe përshpejton procesin e shërimit.

1.11 RREGULLAT E SJELLJES

Sjellja korrekte dhe komunikimi me pacientin dhe familjarët është aspekt tjetër etik i profesionistëve të shëndetit. Sjellja korrekte brenda gjithë normave dhe rregullave të detyrës së caktuar, komunikimi me qetësi, me siguri dhe brenda kompetencave të caktuara është detyrë e çdo punonjësi të shëndetësisë.

- Të mbështesim një kulturë që vlerëson integritetin, ndershmërinë dhe marrëdhëniet e çiltërta me njëri-tjetrin.
- Të përpiqemi të ruajmë një vënd pune ku nuk ndodhin diskriminime, ngacmime dhe sjellje të tjera të papërshtatshme.
- Të inkurajojmë personelin e spitalit të vihet në dijeni për mënyrën që sjellja e tij ose e saj mund të ndikojë tek pacientet, kolegët dhe vizitorët.

Pjesëtarët e personelit spitalor udhëzohen sipas parimeve vijuese të sjelljes.

- Mirësjellje dhe Edukatë
- Mirëdashësi
- Interesim për mirëqënien e të tjerëve
- Ndjeshmëri dhe reagim të menjëhershëm ndaj nevojave të pacientëve
- Bashkëpunim dhe ndihmesë për pacientet, familjet e tyre, vizitorëve dhe bashkëpunëtorëve
- Respekt për pacientët dhe bashkëpunëtorët.

Rregullat janë thelbësore për funksionimin efikas të spitalit.

1.12 NJOHJA ME MASAT DISIPLINORE

Në rast të shkeljes nga punëmarrësi, të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi si dhe akteve të tjera që rregullojnë funksionimin e institucionit, punëdhënesi ose organi kompetent jep një prej masave disiplinore si më poshtë:

- Këshillim.
- Vërejtje
- Vërejtje me paralajmërim për pushim nga puna
- Zbritje në detyrë deri në gjashtë muaj.
- Pagesa e dëmshperblimit.
- Largim nga puna.

1.13 ZHVILLIMI I BURIMEVE NJERZORE: KËRKESA PËR TRAJNIM DHE EDUKIM NË VAZHDIM

Ne mbështesim zhvillimin profesional dhe personal të punonjesve tonë, në rrugën e tyre drejt ndjekjes së misionit që ka spitali. Çdo pjesëtar/personel i stafit pavarësisht nga kushtet e shërbimit do të ketë mundësi të barabarta për të përfituar trajnim dhe edukim në vahdim të ofruar nga spitali. Përzgjedhja e stafit që do të ndjekë kurset e trajnimit, si lokalisht edhe ndërkombëtarisht, do të bazohet në nevojat e shërbimit, interesimin, performancën dhe zhvillimin e kapaciteteve. Përzgjedhja do të bëhet duke patur parasysh eksperiencën individuale dhe përmbajtjen e trajnimit me funksionet e tij/saj brënda spitalit. Përveç trajnimeve të zgjedhura nga Shefi i Shërbimit, çdo pjesëtar i personelit duhet të vendosë synime të zhvillimit profesional në fillim të çdo viti. Këto synime do të rishikohen nga eprori i punonjësit. Arritja e këtyre synimeve do të ndikojë në vlerësimin vjetor të performancës së punonjësit. Dite trainimi (1 ditë trainim d.m.th jo më pak se një orë).

1.14 POLITIKA E MBROJTJES, KONFIDENCIALITETIT DHE INTEGRITETIT TË INFORMACIONIT.

Punonjesit e rinj do të njihen me faktin se Spitali ka përgjegjësi legale dhe etike për të mbrojtur privatësinë e të gjithë pacienteve. Spitali e ka të përcaktuar në rregulloren e brëndshme të tij informacionin që është konfidencial, përfshin komunikimin me të folur, informacion që përmbahet në dokumentacionin manual, ashtu si dhe informacionin e ruajtur në sistemin kompiuterik të spitalit. Të

dhënat për pacientin, personelin, të dhënat finaciare dhe të dhëna të tjera të biznesit përbëjnë informacion konfidencial.

Rregullat e Privatësisë shërbejnë për të mbrojtur konfidencialitetin e të dhënave mjekësore dhe informacioneve të tjera personale shëndetësore. Rregulli kufizon përdorimin dhe dhënien e informacionit shëndetësor individualisht të identifikueshme; jep pacientëve të drejtën për të hyrë në të dhënat e tyre mjekësore; kufizon dhënien e informacionit shëndetësor në minimum të nevojshëm për qëllimet e synuara dhe krijon mbrojtje dhe kufizimet në lidhje me zbulimin e të dhënave për publikun.

1.15 DISA RREGULLA TË THJESHTA

Privatësia dhe konfidencialiteti i informacionit shëndetësor është e drejta e çdo pacienti që kërkon kujdes shëndetësor në spital.

- Pyesni veten: "A duhet ta di këtë gjë për të bërë punën time?" para se të kërkoni në informacionin shëndetësor të pacientit.
- Mos fol për pacientet në vende publike, të tilla si ashensorë apo kafene.
- Mbyll dyert e dhomës se pacientes kur kujdesesh për të ose kur diskuton për shëndetin e saj.
- Fol me zë të ulët kur diskuton për shëndetin e saj
- Zgjidhni në kompjutër fjalëkalime që mund t'i gjeni lehtë.
- Punonjesit të ri i bëhet e qartë se "Të dhënat mjekësore të pacientit mbeten pronë e ofruesit të kujdesit shëndetësor".
- Të dhënat mjekësore origjinale nuk duhet të lëvizen nga mjediset e spitalit, përveçse pas marrjes *leje të posaçme apo* urdhër gjyqësor
- Në kontratën që do të lidhë punonjësi me spitalin duhet të shprehet se: *kupton që informacioni që trajtohet si konfidencial duhet të mbahet në konfidencën më të rreptë. Si kusht i përkatësisë së punonjesit me spitalin, bie dakort që unë, në çdo kohë gjatë ose mbas bashkimit me spitalin, nuk do të zbuloj asnjë informacion konfidencial tek ndonjë person, përveçse kur është e nevojshme në periudhën e kontratës sime me spitalin, dhe kur shoqërohen me persona të autorizuar.*

1.16 POLITIKA KUNDËR DUHANIT

Pirja e duhanit është e ndaluar në të gjitha ambientet spitalore, duke përfshirë pavijonet, dhomat e ngrënies, dhe tualetin. Shkelja e Politikës Kundra Pirjes së Duhanit do të rezultojë në largimin nga mjediset e spitalit. Punonjësit, vullnetarët dhe punonjësit e kontraktuar që shkelin Politikën Kundra pirjes së Duhanit mund të përballen me veprime disiplinore, duke përfshirë edhe përfundimin e kontratës.

1.17 UNIFORMA VESHJA NË SPITAL

Uniforma është detyrim brenda Institucionit. Dalja jashtë Institucionit me uniformën e punës është e dënueshme. Ky veprim ul dinjitetin e punonjësit dhe rrit reziqet për pacientin. Punonjësit e sallave të operacionit, reanimacioneve dhe të të gjitha kabineteve, ku kërkohet sterilitet i veçantë, duhet të përdorin uniformat përkatëse.

Menaxherët dhe mbikëqyrësit janë përgjegjës për interpretimin dhe zbatimin e kësaj politike.

1.18 KODI I VESHJES NË SPITAL

Personeli i spitalit nuk do të mbajë veshjet e përshkruara më poshtë:

- Veshje të shkurtra/ transparente.
- Kapele, ose pajime koke, duke përfshirë kufjet, radiot, celularët, ose pajisjet e tjera për argëtim, gjatë kohës së kryerjes së detyrës, përveç kur nevojitet për arsye sigurie ose si pjesë e uniformës.
- Makijazhi dhe bizhuteritë, parfumi nëse është hedhur në sasi të tepruara.
- Gjatë kryerjes së detyrës së ngarkuar, duhet të mbahen fletëhyrjet e identifikimit, në pjesën e përparme të sipërme të veshjeve, qartësisht të dukshme dhe të pa mbuluara në asnjë mënyrë.
- Modelet e flokëve, mjekrat dhe mustaqet duhet të jenë të pastra për të shmangur infektimet.
- Thonjtë duhet të mbahen të shkurtra, të pastra dhe të punuara me kujdes nuk duhet të mbahen thonj artificialë.
- Çdo Repart Shërbimi ka Uniformën/ Veshjen përkatëse.

1.19 PROGRAMI PËR TË DREJTAT E PERSONELIT

Do të njihet punonjësi i ri me të drejtat kryesore të Politikës së të Drejtave të Personelit.

Spitali ynë njeh këto të drejta të personelit:

- Mosdiskriminimin
- Sigurimin e mundësive të barabarta në vëndin e punës për të ndjekur karrierën e tyre.
- Të raportojë cilindo që është i përfshirë në mashtrime, korrupsion, nepotizëm, keqadministrim dhe çdo veprim tjetër që përbën shkelje pavarësisht pozicionit të tij/saj.
- Të punojë në ambiente pa ngacmime seksuale.
- Të trajtohet me dinjitet dhe respekt nga administrata, personeli, kolegët dhe publiku gjatë gjithë kohës.

1.20 VLERËSIMI I PERFOMANCËS

Çdo punonjës do të vlerësohet në fund të çdo viti. (Në rast se shihet e nevojshme në një periudhë të caktuar.) Vlerësimi vjetor do të bazohet në kriteret vijuese:

- Rezultatet e përgjithshme të arrira
- Aftësia për të kryer detyrat e caktuara
- Cilësia e punës së kryer
- Zbatimi i orarit të punës
- Risitë sugjerime për përmirësimin e punës
- Aftësia për të punuar në grup
- Aftësitë e komunikimit respekti për të tjerët
- Respekti për eprorët, legjislacionin dhe rregullat e spitalit
- Ruajtja e konfidencialitetit

1.21 PJESËMARRJA NË ZHVILLIMIN PROFESIONAL TË VAZHDUESHËM

Dokumentimi i shoqëruar me vlerësimin e personelit do të ruhet në dosjen personale të punonjësit. Punonjësit kanë të drejtën të komentojnë me shkrim mbi rezultatin e procesit të vlerësimit të performancës dhe të apelojnë te Drejtori i Përgjithshëm duke patur parasysh vlerësimet e performancës.

1.22 MUNGESAT NË PUNË DHE PUSHIMI VJETOR

Orët e punës. Orari i funksionimit të spitalit është 40 orë në javë/8 orë në ditë. Orari zyrtar i punës fillon çdo ditë nga ora 8:00 deri në orën 16:30 dhe të premten nga ora 8:00 deri në orën 14:00. Të shtunat dhe të dielat janë pushim sikurse dhe ditet e festave. Orari i punës për personelin mjekësor dhe punonjësit e tjerë është nga ora 8:00 deri në orën 16:00 dhe për infermieret nga ora 7:00 deri në orën 15:00. Mund të propozohen orë shërbimi speciale nga Shefi i Repartit dhe kjo është çështje për miratim nga Drejtori i Përgjithshëm.

Mungesat në punë klasifikohen: 1 ditë, 3 ditë, më shumë se 3 më pak se 41 ditë. Kur një punonjës mungon në punë për arsye shëndetësore, ai ose ajo do të njoftojë eprorin e tij ose të saj në lidhje me kohëzgjatjen e menduar të mosparaqitjes gjatë ditës së mëpasme të punës.

Spitali do të përgatisë një formular vlerësimi nga ana e punonjësve të rinj, për të parë nëse nëpërmjet këtij programi kemi arritur atë që ne dëshirojmë nga punonjësit, dhe ku mund të përmiresojmë punën tonë nëpërmjet sugjerimeve apo vështiresive të hasura.

VLERËSIMI I PROGRAMIT TË ORIENTIMIT

Ju lutem përdorni shkallët e meposhtme per te na ndihmuar ne vleresimin e programit tone te orientimit.

3 = i qarte

2 = kryesisht i qartë

1 = i pamjaftueshem

Si ndiheni tani:

_____ 1. Unë jam i gatshem për të filluar punën

_____ 2. Unë ndjehem i/e mirëpritur këtu.

_____ 3. Unë parashikoj një marrëdhënie pozitive pune me eprorin tim

_____ 4. Unë parashikoj një marrëdhënie pozitive pune me kolegët në departamentin tim

Objektivat e Orientimit:

_____ 5. Kam marrë informacion thelbësor.

_____ 6. Unë e di se çfarë pritet prej meje nga eprori im.

_____ 7. Unë kuptoj përgjegjësitë e mia të punës.

_____ 8. Unë kam furnizimet thelbesore dhe paisjet për të bërë punën time

9. Cilat ishin pikat më të dobishme te mbuluara gjatë orientimit?

.....

10. Çfarë informacioni nuk eshte mbuluar nga ky program që ju do te dëshironit të dinit?

.....

11. Komente tetjera ……

2. PJESA E DYTE: PERSHKRIMET E PUNES

PERSHKRIM PUNE

Institucioni :	SUOGJ "Mbreteresha Geraldine"
Emri Mbiemri :	_____
Titulli i punes :	Zv/Drejtor Ekonomik.
Data e emerimit ne kete pozicion :	_____

POZICIONI ORGANIZATIV



- Zv/Drejtori Ekonomik, varet nga titullari i Institucionit (Drejtori) dhe ka ne vartesi te drejtperdrejte :
  - Sektorin e Finaces
  - Sektorin Teknik
  - Sektorin e Prokurim Furnizimit
  - Sektorin e Hotelerise
- Zv/Drejtori Ekonomik, ka ne varesi dyfishe Sektorin e Burimeve Njerezore dhe Juristin.

QELLIMI I PUNES:

Te jape nje siguri te arsyeshme per titullarin e Institucionit, per perdorimin me eficience, efektivitet dhe ekonomicitet te burimeve financiare publike, duke respektuar parimet e transparences dhe te ligjshmerise, frytshmerine e sistemeve te kontrollit te brendshem si dhe shmangia e shperdorimit, keqperdorimit dhe vjedhjes se pasurise, plotesimin e informacionit financiar dhe te drejtimit si dhe perdorimin e tyre ne procesin e vendimmarjes.

PERGJEGJESITE KRYESORE:

- Zv/Drejtori Ekonomik, eshte pergjegjes dhe i raporton titullarit te Institucionit per zbatimin e sistemeve te menaxhimit financiar dhe kontrollit ne te gjitha njesite, strukturat, programet, veprimtarite dhe proceset qe menaxhohen prej tij, ne perputhje me parimet e ligjshmerise, menaxhimit te shendoshe financiar dhe te transparences.
- I propozon titullarit te Institucionit akte te brendshme administrative, monitoron dhe perditeson sistemet per menaxhimin financiar dhe kontrollin, brenda kuadrit rregullator qe ka miratuar Ministria e Financave, si dhe merr masa per permiresimin e sistemeve, ne vijim te rekomandimeve te auditit te brendeshem, auditit te jashtem dhe te vleresimeve e analizave te tjera.
- Eshte pergjegjes per planifikimin, menaxhimin, kontabilitetin dhe raportimin financiar te veprimtarise se Institucionit.

DETYRAT KRYESORE:

- Drejton, planifikon, organizon, kontrollon dhe koordinon punen e sektoreve te varesise, ne perputhje me programin vjetor te Institucionit.
- Harton dhe i paraqet per miratim titullarit te Institucionit planet strategjik dhe vjetor ne perputhje me objektivat e miratuara nga titullari i Institucionit.
- Harton dhe ndjek zbatimin e buxhetit ne perputhje me politikat e zhvillimit shendetesor dhe analizon treguesit ekonomik-financiar, statistikor dhe propozon rruget per rritjen e efektivitetit te tyre.
- Monitoron kontrollin e risqeve, qe vene ne rrezik arritjen e objektivave te strukturave qe menaxhon. Informon ne kohe dhe ne formen e kerkuar per rezultatet e arritura gjate permbushjes se pergjegjesise se tij, per risqet dhe difektet serioze ne veprimtarine e strukturave qe drejton si dhe masat e marra e te zbatuara per riparimin e ketyre difekteve.
- Pergatitja dhe monitorimi i sistemeve per ruajtjen dhe mbrojtjen e aktiveve dhe dokumentacionit kundrejt humbjeve, vjedhjeve, keqperdorimit dhe perdorimit te paautorizuar.
- Ndermer masa, ne raport me riskun per sigurine dhe kufizimin e humbjeve financiare duke hartuar ne bashkepunim me sektoret perkates planet e emergjences per vleresimin e te gjitha pasojave potenciale te riskut si nga faktore te jashtem ashtu edhe nga ata te brendshem. Menaxhon krizat dhe zbatimin e planit gjate dhe pas nje incidenti.

DETYRA DHE PERGJEGJESI TE TJERA TE SHPREHURA NE MENYRE ME ANALITIKE.

- Organizon dhe bashkerendon punen me sherbimet per detajimin e buxhetit te akorduar dhe planifikimin e perdorimit te tij.
- Ne bashkepunim me Zv/Drejtorin Mjeksor dhe Shefat e Sherbimeve, organizon dhe drejton punen per planifikimin e nevojave per blerje medikamente, kite & reagente dhe materiale konsumit mjeksor gjate vitit.
- Ne bashkepunim me Shefat e Sektoreve te varesise, organizon dhe drejton punen per hartimin e specifikimeve teknike dhe testimin e tregut kur kerkohet nje gje e tille per planifikimin e fondit limit per artikujt qe do prokurohen.
- Organizon dhe ndjek raportimet periodike te realizimit te buxhetit, te ardhurave, kostos dhe fuqise punetore sipas formatit te evidencave qe kerkohen nga strukturat qe vene fondet ne dispozicion.
- Ne baze te raportimit periodik te Shefave te Sektoreve, kryen analiza mbi realizimin e treguesve te buxhetit, punen e bere ne drejtim te plotesimit te nevojave te Institucionit me medikamente dhe bazen e nevojshme materiale qe ndikon ne sherbimin ndaj nenes dhe femijes.
- Ne bashkepunim me Shefat e Sherbimeve apo Sektoreve organizon dhe drejton punen per vendosjen e normativave te konsumit te materialeve te konsumit (materiale laboratorike, solucioneve larese, disifektavteve etj.)
- Nepermjet raportimeve periodike, monitoron realizimin e procedurave te prokurimit dhe procedurave te pranimit te mallit apo sherbimit sipas specifikimeve teknike te kontraktuara.
- Ne bashkepunim me Zv/Drejtorin Mjeksor, Farmacine dhe Shefat e Sherbimeve apo Sektoreve, kryen analiza te konsumit te medikamenteve dhe materialeve te tjera, duke i dhene perparesi vleresimit te kostos se medikamenteve perpara vendosjes se terapise se trajtimit te pacienteve si dhe duke ndjekur ne menyre te vecante menjanimin e krijimit te mallrave stoqe apo me qarkullim te ngadalshem.
- Ne bashkepunim me Sektorin Teknik, organizon punen per mirembajtjen e objekteve ndertimore dhe aparaturave mjeksore.
- Mbi bazen e vleresimit te risqeve, organizon kontrolle te brendshme te planifikuara apo te befasishme per monitorimin e sistemeve dhe mbrojtjen e aktiveve.
- Mbikqyrjen dhe menaxhimin efektiv te punonjesve te strukturave qe drejton dhe ruajtjen e nivelit te tyre profesional.

- Krijimin e kushteve per menaxhim te ligjshem, efektiv e te pershtatshem dhe per sjellje etike te punonjesve. Vlereson punen e punonjesve te varesise, kontrollon perdorimin e kohes se punes, zbatimin e kodit etik te punonjesve dhe kur verehen shkelje, kerkon fillimin e ecurise disiplinore per nenpunesit e varesise ne baze te Kodit te Punes dhe Rregullores se Brendshme te Institucionit.
- Detyra te tjera qe caktohen nga titullari i Institucionit (Komisione prokurimi, dhurimi ose sponsorizimi, vleresimi, kontrolli etj).

VENDIMARJA:

- Harton dhe i paraqet per miratim titullarit te Institucionit akte administrative, rregulla, metodologji, procedura dhe udhezime mbi zbatimin e sistemeve te menaxhimit financiar dhe kontrollin.
- Te propozoje masa me karakter zhdemtimi, administrative dhe disiplinore kur vertetohen shkelje, paregullsi dhe deme.
- Ben perzgjedhjen e personelit te varesise, mbi bazen e konkurimit dhe ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.
- Vlereson punen e punonjesve te vartesise.

KONTAKTET DHE PERFAQESIMI.

Mban kontakte te vazhdueshme me strukturat drejtuese dhe menaxhuese ne Ministrine e Shendetesie, ISKSH-ne, DSKSH-ne, Degen e Thesarit si dhe strukturat homologe te Institucioneve te tjera.

NJOHURITE, AFTESITE DHE EKSPERIENCA.

- Te kete mbaruar studimet universitare ne shkencat ekonomike.
- Te kete pervoje pune jo me pak se pese vjet ne fusha qe kane te bejne me menaxhimin financiar dhe kontrollin.
- Te kete aftesi te mira komunikuese, zhvillimit te punes ne grup dhe perhapes i ideve te reja.
- Per shkak te detyrave me karakter menaxherial nevoiten aftesi te mira drejtuese dhe organizuese.
- Te kete njohuri te nje gjuhe te huaj dhe te perdore programet baze te punes me kompjuter.

KERKESA FIZIKE

Ne kete pozicion mund te punoje cdo shtetas shqiptar me zotesi te plote juridike per te vepruar si dhe me njohurite, aftesite dhe eksperiencen e vleresuar si me lart.

KUSHTET E PUNES

Kushtet e punes zhvillohen nen nje mjedis te qete, me kushtet optimale dhe ne nje ambjent konkurues duke krijuar nje mjedis pune qe lejon dhe favorizon zhvillimin e aftesive dhe karrieres.

PËRSHKRIM I PUNËS	
Departamenti :	Administrate
Titulli i punës:	Arshive/Protokoll
Raporton Tek:	Drejtori

QËLLIMI I PUNËS:

Protokollon, administron dhe pergjigjet per administrimin e dokumentave te krijuara apo te ardhura ne adrese te Institucionit.

PËRGJEGJËSITË DHE DETYRAT KRYESORE

- Administron teresine e dokumentave te krijuara dhe te ardhura ne Institucion .
- Krijon kushte per shfrytezimin e dokumentacionit arkivor si dhe per ruajtjen dhe garantimin fizik te tyre.
- Merr ne dorezim korespondencen e ardhur, i evidenton ato dhe i shperndan sipas destinacionit te dhene nga titullari.
- Kryen proçedurat per dokumentet qe krijon Institucioni dhe pergatit rregullisht nisjen e korrespodences ditore.
- Krijon dosjet provizore dhe kushtet per lehtesi shfrytezimi dhe sistemimi te dokumentave.
- Ruan vërtetësinë e dokumentave gjatë përpunimit ,ruajtjes dhe shfrytezimit të tyre.
- Bashkerendohet puna me sekretarinë ,duke marre pjese ne mbylljen e dosjeve te hapura sipas pasqyres emertuese te çeljes se dosjeve .
- Mban pergjegjesi per çdo shkrese qe leshohet ose merr institucioni duke ruajtur konfidencialitetin.
- Mban pergjegjesi per protokollimin e shkresave ne menyre te rregullt dhe konform ligjit.
- Mban vulen e institucionit duke mos lejuar abuzimet.
- Arshivon te gjithe dokumentacionin te ndare sipas objektit dhe viteve ,
- Nuk nxjerr nga arshiva/protokolli asnje dokument pa urdherin e drejtorit apo zevendesit te tij si dhe ne prezence te shefit te sektorit.
- Kryen detyra te tjera qe kerkohen nga drejtuesi.

NJOHURITË, AFTËSITË DHE EKSPERIENCA:

- Diplome universiteti ne fushen sociale apo te komunikimit.
- Te kete pervoje pune ne fushen e sekretarise, arshives dhe administrimit te zyres.
- Certifikata te trajnimeve dhe kualifikimeve te tjera ne funksion te detyres.
- Te kete aftesi te shkelqyera ne komunikim, ne punen e ekipit dhe individuale.

KËRKESA FIZIKE:

Ne kete pozicion mund te punoje çdo person i cili zoteron njohurite, aftesite dhe eksperiencen sipas vleresimit te pergjithshem. Kërkohet përdorimi i duarve dhe qëndrimi në këmbë për një kohë të gjatë.

KUSHTET E PUNËS:

Proçesi i punës zhvillohet në një mjedis të ndriçuar i cili ofron mundësitë për kryerjen optimale të punës. Gjithashtu, një ambjent konkurues ndihmon në zhvillimin e aftësive personale dhe në rritjen e rendimentit të punës.

PËRSHKRIM I PUNËS	
Departamenti:	Administrate
Titulli i punës:	Specialiste e Marrdhenieve me Publikun dhe Edukimin ne Vazhdim
Raporton Tek:	Shefi Burimeve Njerezore

QËLLIMI I PUNËS:

Eshtë përgjegjës për përgatitjen dhe ndjekjen e informacionit për të gjithë veprimtarinë e Spitalit Universitar Obstetrike- Gjinekologjjik. Drejton dhe mbikqyr programet arsimore ne te gjithe spitalin. Punon ngushte me te gjithe stafin spitalor per zhvillimin e programeve dhe burimeve per te permbushur nevojat e edukimit ne vazhdim.

PËRGJEGJËSITË DHE DETYRAT KRYESORE

- Harton dhe zbaton planin e informimit të publikut, programet dhe oraret e informimit të publikut
- Organizon, planifikon të gjitha aktivitetet nga fusha e informimit, përfshirë takimet me gazetarë, si dhe njofton opinionin mbi aktivitetet e Spitalet
- Përcjell të gjitha takimet e Menaxhmentit dhe të zyrtarëve të saj si dhe aktivitetet tjera të Spitalit
- Zhvillon, komunikon dhe menaxhon planin e promovimit të imazhit pozitiv të Institucionit
- Bashkëpunon me media me qellim të informimit të drejt të aktiviteteve të spitalit
- Planifikon publikime, njoftime dhe aktivitete tjera periodike me qëllim të informimit të qytetareve dhe transparencës para tyre, lidhur me aktivitetet e Spitalit
- Përgatit dhe monitoron studime të ndryshme mbi atë se sa janë të kënaqur konsumatorët me shërbimet e ofruara
- Menaxhon web faqen e Institucionit
- Shërben si ndërlidhje në mes të komunitetit dhe spitalit në zhvillimin e programeve të vazhdueshme arsimore.

NJOHURITË, AFTËSITË DHE EKSPERIENCA:

- Diplome universiteti ne fushen sociale apo te komunikimit.
- Te kete pervoje pune jo me pak se 2 vite
- Certifikata te trajnimeve dhe kualifikimeve te tjera ne funksion te detyres.
- Te kete aftesi te shkelqyera ne komunikim, ne punen e ekipit dhe individuale.

KËRKESA FIZIKE:

Ne kete pozicion mund te punoje çdo person i cili zoteron njohurite, aftesite dhe eksperiencen sipas vleresimit te pergjithshem. Kërkohet përdorimi i duarve dhe qëndrimi në këmbë për një kohë të gjatë.

KUSHTET E PUNËS:

Proçesi i punës zhvillohet në një mjedis të ndriçuar i cili ofron mundësitë për kryerjen optimale të punës. Gjithashtu, një ambjent konkurues ndihmon në zhvillimin e aftësive personale dhe në rritjen e rendimentit të punës.

PËRSHKRIM I PUNËS	
Departamenti :	Administrate
Titulli i punës:	Sekretare e Drejtorit
Raporton Tek:	Drejtori

QËLLIMI I PUNËS:

Sekretari/a e Drejtorit te Spitalit eshte pergjegjese per sigurimin e mbeshtetjes sekretariale, administrative dhe çeshtjeve te tjera te zyres se Drejtorit, me qellim qe lidhja midis drejtorit, personelit te spitalit dhe publikut ne pergjithesi te funksionoje ne menyre efektive dhe efiçente.

PËRGJEGJËSITË DHE DETYRAT KRYESORE

- Sekretarja varet direkt nga Drejtori i Spitalit.
- Eshte pergjegjese per lidhjet e drejtorit me punonjesit e administrates dhe sherbimet.
- Mban pergjegjesi per çdo shkrese qe leshohet ose merr Institucioni duke ruajtur konfidencialitetin.
- Qendron gjate gjithe kohes prane telefonit te sekretarise per te marre çdo mesazh saktesisht dhe i'a referon ato drejtorit.
- Merr pjese ne te gjitha mbledhjet qe organizon drejtori duke mbajtur protokollin e zhvillimit te mbledhjes.
- Shtyp te gjitha materialet qe dalin nga drejtoria.
- Tregon gadishmeri per t'iu pergjigjur detyres dhe pergjegjesive qe rrjedhin prej saj, duke permbushur vazhdimisht standartet ne pune.
- Drejton personat e interesuar tek anetaret respektive te stafit.
- Asiston ne planifikimin dhe pergatitjen e takimeve dhe konferencave.
- I permbahet Kodit te Sjelljes se Spitalit.
- Miremban nje inventar te pershtatshem te pajisjeve te zyres.
- Performon me takt dhe ne menyre profesionale.
- Detyra te tjera te caktuara nga Drejtori.

NJOHURITË, AFTËSITË DHE EKSPERIENCA:

- Diplome universiteti ne fushen sociale apo te komunikimit.
- Te kete pervoje pune ne fushen e sekretarise, arshives dhe administrimit te zyres.
- Certifikata te trajnimeve dhe kualifikimeve te tjera ne funksion te detyres.
- Te kete aftesi te shkelqyera ne komunikim, ne punen e ekipit dhe individuale.

KËRKESA FIZIKE:

Ne kete pozicion mund te punoje çdo person i cili zoteron njohurite, aftesite dhe eksperiencen sipas vleresimit te pergjithshem. Kërkohet përdorimi i duarve dhe qëndrimi në këmbë për një kohë të gjatë.

KUSHTET E PUNËS:

Proçesi i punës zhvillohet në një mjedis të ndriçuar i cili ofron mundësitë për kryerjen optimale të punës. Gjithashtu, një ambjent konkurues ndihmon në zhvillimin e aftësive personale dhe në rritjen e rendimentit të punës.

PËRSHKRIM I PUNËS

Departamenti:	Administrate
Titulli i punës:	Specialiste e Burimeve Njerezore
Raporton Tek:	Shefi Burimeve Njerezore

QËLLIMI I PUNËS:

Eshtë përgjegjës per administrimin e ndryshem dhe funksionimin e sektorit te Burimeve Njerezore, duke perfshire planifikimin dhe zhvillimin e fuqise punetore per te permbushur kerkesat e personelit te spitalit, si dhe per te keshilluar stafin ne menaxhimin dhe zbatimin e politikave dhe procedurave te spitalit.

PËRGJEGJËSITË DHE DETYRAT KRYESORE

- Ploteson kontratat individuale te perkohshme dhe definitive te personelit te spitalit sipas urdherave dhe ligjeve ne fuqi.
- Trajton ceshtjet dhe problemet e punonjesve
- Themelon dhe miremban te gjitha dosjet personale te stafit
- Ploteson listeprezencen e punonjesve
- Trajton verifikimet te kerkuara nga punonjesit apo/edhe nga institucionet tjera
- Ndjek praktiken mesimore te studenteve
- Ndjek zbatimin e orarit te punes te punonjesve te Spitalit.
- Propozon titullarit marrjen e masave administrative per personat qe shkelin rregullat e etikes ne pune.
- Ne fund te çdo viti verifikon dosjet e gjithe personelit per ndryshimet dhe plotesimet qe kane pasur.
- Ndjek procedurat e konkurimit dhe emerimit te personelit.
- Ndjek procedurat e shtesave te pagave duke perfshire vjetersine dhe veshtersine ne pune, nivelin shkencor, dhe daljen ne pension.
- Ndihmon shefat e sherbimeve ne procesin e perzgjedhjes dhe intervestimit te kandidateve.
- Detyra te tjera te ngarkuara nga Shefi Sektorit te Burimeve Njerezore dhe Drejtori i Spitalit.

NJOHURITË, AFTËSITË DHE EKSPERIENCA:

- Diplome universiteti ne administrim biznesi apo ne ndonje fushe te ngjashme.
- Te kete pervoje pune jo me pak se 2 vite.
- Certifikata te trajnimeve dhe kualifikimeve te tjera ne funksion te detyres.
- Te kete aftesi te shkelqyera ne komunikim, ne punen e ekipit dhe individuale.

KËRKESA FIZIKE:

Ne kete pozicion mund te punoje çdo person i cili zoteron njohurite, aftesite dhe eksperiencen sipas vleresimit te pergjithshem. Kërkohet përdorimi i duarve dhe qëndrimi në këmbë për një kohë të gjatë.

KUSHTET E PUNËS:

Proçesi i punës zhvillohet në një mjedis të ndriçuar i cili ofron mundësitë për kryerjen optimale të punës. Gjithashtu, një ambjent konkurues ndihmon në zhvillimin e aftësive personale dhe në rritjen e rendimentit të punës.

PËRSHKRIM I PUNËS	
Departamenti:	Administrate
Titulli i punës	Z v Drejtor Teknik
Raporton Tek:	Drejtori i Pergjithshem

QELLIMI I PUNES:

Zv.Drejtori Teknik eshte pergjegjes per menaxhimin e aktivitetit mjeksor te mjekeve te spitalit konform rregullores se brendshme te Spitalit dhe polikave te Ministrise se Shendetesise

DETYRAT DHE PERGJEGJESITE KRYESORE

- Emerimi dhe shkarkimi i zv/drejtorit teknik behet nga Ministri i Shendetesise me propozim te Drejtorit te spitalit.
- Organizon, drejton dhe kontrollon veprimtarine tekniko – mjeksore te Spitalit, mbi trajtimin e pacienteve ne Spital, konsultat, analizat tekniko – shkencore, analizat e vdekjeve (oponencat), treguesit e efiçences se trajtimit te te semureve etj.
- Pergjigjet se bashku me shefat e sherbimeve per kualifikimin e mjekeve dhe personelit mjekesor.
- Organizon studime mbi semundshmerine, vdekshmerine dhe percakton masat per parandalimin e tyre.
- Ndjek realizimin e treguesve te efiçences Spitalore dhe ne bashkepunim me shefat e sherbimit percakton rruget dhe menyren e permiresimit te vazhdueshem te cilesise se kujdesit Spitalor.
- Ne bashkepunim me komisionin mjeksor te Spitalit planifikon dhe organizon studime, seminare apo sesione shkencore qe lidhen me veprimtarine e Spitalit.
- Pergjigjet per koordinimin dhe bashkerendimin punes ndermjet sherbimeve, njesive te ndryshme dhe Drejtorise.
- Ne mungese te Drejtorit, zevendeson ate, merr te gjitha atributet e tij dhe pergjigjet per mbarevajtjen e punes ne Spital.
- Ne bashkepunim me Shefat e Sherbimeve dhe K/infermieren e Pergjithshme organizon dhe kontrollon punen per zbatimin e politikave te spitalit per kontrollin e vizitoreve konform rregullores se miratuar nga Drejtoria.
- Organizon, planifikon dhe menaxhon nevojat vjetore per medikamente dhe materiale per perdorim mjekesor ne bashkepumin me sherbimin farmaceutik dhe shefat e sherbimeve.
- Kerkon informacion periodik nga Pergjegjesi i Farmacise ne lidhje me medikamentet stok dhe atyre me qarkullim te ngadalshem me qellim miremenaxhimin e tyre.
- Detyra te tjera qe caktohen nga Komisioni mjeksor ose Drejtori i Spitalit.

KERKESAT MINIMALE

Aftesite dhe zotesite e kerkuara

- Njohuri dhe aftesi per te zbatuar rregullat dhe ligjet ne fuqi persa i perket pozicionit te punes.
- Duhet te kete aftesi te mira komunikimi dhe ndërveprimi me bashkepunetoret.
- Performon me takt dhe ne menyre profesionale.

Arsimimi dhe eksperienca minimale

Te kete arsim te larte .Te jete i diplomuar prane universitetit shteteror apo ndonje universiteti privat qe eshte i akredituar nga Ministria e Arsimit dhe Shkences ne Fakultetin e Mjekesise. Ne qofte se ka kryer studimet universitare jashte kufijve te shtetit shqiptar te kete me vete dokumentin per njohjen e ketyre studimeve nga Ministria e Arsimit dhe Shkences.

MBIKEQYRJA E KRYER NGA:

Zv. Drejtori teknik ka vartesi direkte nga drejtori i Spitalit.

EDUKIMI, AFTËSITË DHE EKSPERIENCA:

- Te jete i diplomuar ne Mjekesi te Pergjithshme prane Fakultetit te Mjekesise ne Tirane apo prane ndonje universiteti privat qe eshte i akredituar nga Ministria e Arsimit dhe Shkences. Ne qofte se ka kryer studimet universitare jashte kufijve te shtetit shqiptar te kete me vete dokumentin per njohjen e ketyre studimeve nga Ministria e Arsimit dhe Shkences.
- Te kete kryer studimet pasuniversitare ne specialitetin e obstetrike-gjinekologji dhe te kete me vete dokumentin e njohjes se ketyre studimeve nga Ministria e Arsimit dhe Shkences ne rast se keto studime jane kryer jashte kufijve te shtetit shqiptar.
- Te jete i rregjistruar dhe i licensuar nga Urdheri i Mjekut, organ ky kompetent qe te jep te drejten e ushtrimit te profesionit.

AFTESITE DHE ZOTESITE E KERKUARA

- Njohuri dhe aftesi per te zbatuar parimet profesionale mjekesore, procedurat dhe teknikat mjekesore.
- Njohuri te plote te agjenteve farmakologjike qe perdoren ne trajtimin e pacientit.
- Duhet te kete aftesi te mira komunikimi per kontaktin me pacientet, dhe me ndërveprimin me bashkepunetoret.
- Performon me takt dhe ne menyre profesionale.

DETYRAT MBIKEQYRESE:

- Ne spital bejne roje te gjithe specialistet sipas kritereve te grafikut te bere dhe te miratuar nga zv/drejtori teknik i Spitalit.
- Mjeku roje pergjigjet per te gjithe te semuret e shtruar ne spitalj dhe ndjek me preçedence te semuret problematike sipas sherbimeve dhe mjekeve kurues, duke shenuar dekursin ne kartele mbi ecurine e gjendejes se semurit.
- Bashkepunon me mjeket e tjere dhe vendos per ata te semure qe duhet te shtrohen ne Spital duke i plotesuar dokumentacionin perkates.
- Kontrollon gjendjen ne te gjitha repartet e sherbimit qe mbulon dhe jep ndihme mjekesore per te semuret qe kane probleme.
- Ne raste te veshtira njofton specialistet e tjere per konsulte.
- Pergjigjet per te gjitha kerkesat qe ben personeli i sherbimit te reparteve dhe i zgjidh ato ose ve ne dijeni shefin e sherbimit dhe ne pamundesi dhe drejtorin e Spitalit.
- Kontrollon angazhimin ne pune te personelit naten.
- Per te gjitha vizitat qe ben shenon ne kartele gjendjen e te semurit, mjekimin plotesues ose analizat dhe per te gjitha keto ve ne dijeni mjekun kurues gjate dorezimit te sherbimit.
- Ne rastet e konstatimit te shkeljeve te disiplines merr masa deri ne largimin nga puna te personave pergjegjes, por gjithmone duke siguruar sherbimin dhe ve ne dijeni Shefin e Sherbimit.
- Per ngjarje te jashtezakonshme njofton Drejtorin e Spitalit, ne mungese te tij zevendesin.
- Pasi mbaron sherbimin, shenon ne librin e mjekut te rojes shtrimet, konsultat me te semuret problematike, ndodhite e 24 – oreshit, dhe i raporton ato ne mbledhjen e mengjesit. Dorezimi i behet me shkrim mjekut tjeter qe merr sherbimin.

KËRKESA FIZIKE:

- Ne kete pozicion mund te punoje çdo person i cili zoteron njohurite, aftesite dhe eksperiencen sipas vleresimit te pergjithshem.

- Kërkohet përdorimi efektiv i duarve dhe qëndrimi në këmbë për një kohë të gjatë.
- Ekspozim ndaj lendeve kimike, lengjeve trupore te cilat mund te jene toksike ose infektive.
- Dokument qe tregon aftesine e tij

KUSHTET E PUNËS:

Proçesi i punës zhvillohet në një mjedis të ndriçuar i cili ofron mundësitë për kryerjen optimale të punës. Gjithashtu, një ambjent konkurues ndihmon në zhvillimin e aftësive personale dhe në rritjen e rendimentit të punës.

PËRSHKRIM I PUNËS	
Departamenti:	Administrate
Titulli i punës	Z v Drejtor per Cilesine
Raporton Tek:	Drejtori i Pergjithshem

QELLIMI I PUNES

Zv Drejtori per Cilesine drejton komitetin e cilesise se spitalit bazuar ne dokumetat baze

- Statuti SUOGJ "Mbreteresha Geraldine"
- Standartet e Sherbimeve Spitalore ne Shqiperi (Botim 2042-2005)
- Vendime te Ministrise dhe te SUOGJ te lidhura me cilesine
- Vendimi per bashkepunim me gjysmen e Spitaleve rajonale te Shqiperise.

DETYRAT DHE PERGJEGJESITE THEMELORE

- Emerimi dhe shkarkimi i zv/drejtorit per cilesine behet nga Ministri i Shendetesise me propozim te Drejtorit te spitalit.
- Organizon, drejton dhe kontrollon veprimtarine e organizmave dhe njesive ne funksion te cilesise te sherbimit. Te tilla jane:
  - Komiteti Spitalor per cilesine
  - Komisioni per kontrolin e infeksioneve
  - Komisioni i programit te orientimit te personelit
  - Politika e raportimit te incidenteve, vizitoret etj.
- N/Drejtori per cilesine ka vemendje si me poshte:
  - Perpilimi i programit per funksionimimin e çdo komisioni te premedur si dhe permiresimin ne vazhdim te ketyre programeve.
  - Perpilimi e kalendarit te funksionimit per çdo njesi ne sherbim te cilesise.
  - Sigurimin e bashkepunimin me shkembim eksperience me spitale te ngjashem me tonin.
  - Bashkepunim dhe shkembim eksperiencash me spitalet rajonale qe kemi ne patronazh.
  - Analize periodike e aktiviteteve te lidhura me cilesine
  - Sugjerim drejtorise se spitalit per nderhyrje te ndryshme ne permiresimin e cilesise.
  - Publikimin e arritjeve te cilesise dhe krahasimin e tyre me veten dhe te tjeret.
  - Organizimin e takimeve kombetare dhe nderkombetare per cilesine.
- Bashkepunon ngushtesisht me shefat e sherbimeve, me drejtuesit e sherbimeve mbeshtetse, dhe ne menyre te vecante me kryemamin e pergjithshme
- Shfrytzon per vlersimin e cilesise keto instrumente:
  - Cilesine e sherbimeve spitalore ne Shqiperi botim OBSh, MSh
  - Mjet vleresimi per cilesine botim OBSH, MSH 2011
  - Indikatoret per vleresimin e cilesise botim MSH
  - Kujdeset ne vazhdim per te njohur te rejat nderkombetare per vleresimin e cilesise ne spital
- Detyra te tjera qe caktohen nga Drejtori i Spitalit.

KERKESAT MINIMALE

Aftesite dhe zotesite e kerkuara

- Njohuri dhe aftesi per te zbatuar rregullat dhe ligjet ne fuqi persa i perket pozicionit te punes.
- Duhet te kete aftesi te mira komunikimi dhe ndervepimi me bashkepunetoret.

- Performon me takt dhe ne menyre profesionale.

Arsimimi dhe eksperienca minimale

Te kete arsim te larte .Te jete i diplomuar prane universitetit shteteror apo ndonje universiteti privat qe eshte i akredituar nga Ministria e Arsimit dhe Shkences ne Fakultetin e Mjekesise. Ne qofte se ka kryer studimet universitare jashte kufijve te shtetit shqiptar te kete me vete dokumentin per njohjen e ketyre studimeve nga Ministria e Arsimit dhe Shkences.

MBIKEQYRJA E KRYER NGA:

Ka vartesi direkte nga drejtori i Spitalit.

EDUKIMI, AFTËSITË DHE EKSPERIENCA:

- Te jete i diplomuar ne Mjekesi te Pergjithshme prane Fakultetit te Mjekesise ne Tirane apo prane ndonje universiteti privat qe eshte i akredituar nga Ministria e Arsimit dhe Shkences. Ne qofte se ka kryer studimet universitare jashte kufijve te shtetit shqiptar te kete me vete dokumentin per njohjen e ketyre studimeve nga Ministria e Arsimit dhe Shkences.
- Te kete kryer studimet pasuniversitare ne specialitetin e obstetrike-gjinekologji dhe te kete me vete dokumentin e njohjes se ketyre studimeve nga Ministria e Arsimit dhe Shkences ne rast se keto studime jane kryer jashte kufijve te shtetit shqiptar.
- Te jete i rregjistruar dhe i licensuar nga Urdheri i Mjekut, organ ky kompetent qe te jep te drejten e ushtrimit te profesionit.

AFTESITE DHE ZOTESITE E KERKUARA

- Njohuri dhe aftesi per te zbatuar parimet profesionale mjekesore, procedurat dhe teknikat mjekesore.
- Njohuri te plote te agjenteve farmakologjike qe perdoren ne trajtimin e pacientit.
- Duhet te kete aftesi te mira komunikimi per kontaktin me pacientet, dhe me ndërveprimin me bashkepunetoret.
- Performon me takt dhe ne menyre profesionale.

DETYRAT MBIKEQYRESE:

- Ne spital bejne roje te gjithe specialistet sipas kritereve te grafikut te bere dhe te miratuar nga zv/drejtori teknik i Spitalit.
- Mjeku roje pergjigjet per te gjithe te semuret e shtruar ne spitalj dhe ndjek me preçedence te semuret problematike sipas sherbimeve dhe mjekeve kurues, duke shenuar dekursin ne kartele mbi ecurine e gjendejes se semurit.
- Bashkepunon me mjeket e tjere dhe vendos per ata te semure qe duhet te shtrohen ne Spital duke i plotesuar dokumentacionin perkates.
- Kontrollon gjendjen ne te gjitha repartet e sherbimit qe mbulon dhe jep ndihme mjekesore per te semuret qe kane probleme.
- Ne raste te veshtira njofton specialistet e tjere per konsulte.
- Pergjigjet per te gjitha kerkesat qe ben personeli i sherbimit te reparteve dhe i zgjidh ato ose ve ne dijeni shefin e sherbimit dhe ne pamundesi dhe drejtorin e Spitalit.
- Kontrollon angazhimin ne pune te personelit naten.
